



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

RAPORT

Mbi ecurinë e punës në IKP për vitin 2022

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca kryesore:


- a. Ushtron ankim ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankim i cili shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 179/b/5 i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2, neni F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës dhe neni 63/1 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim, për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Ky raport statistikor përmban të dhëna për veprimtarinë në tërësi të IKP-së gjatë vitit 2022, si dhe gjatë gjithë periudhës së funksionimit të institucionit, shkurt 2018 - 2022.

I. STATISTIKË E PROCESIT


Tabelë përmbledhëse

Periudha	Vendime të njoftuara nga KPK	Dispozitivi i vendimit të njoftuar			Rekomandime nga ONM	Ankime	Mosankime
		Konfirmim në detyrë	Shkarkim nga detyra	Ndërprerje procesi			
Viti 2018	77	33	29	15	5	16	61
Viti 2019	127	55	44	28	5	13	114
Viti 2020	103	35	38	30	3	16	87
Viti 2021	171	62	68	41	8	14	157
Viti 2022	109	50	36	23	2	11	98
Totali	587	235	215	137	23	70	517




Grafiku nr. 1 - Statistika përmbledhëse, 2018-2022

Statistikë përmbledhëse - dispozitivi i vendimeve - 2018-2022



Grafiku nr. 2 - Vendime të njoftuara në IKP sipas dispozitivit, 2018-2022

Shkurt 2018 - 31 dhjetor 2022




Grafiku nr. 3 - Ankime të Komisionerëve Publikë

- Vendime të njoftuara nga KPK-ja

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në referencë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2022, është njoftuar për 109 vendime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Ecuria e njoftimeve të tyre sipas muajve është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku nr. 4 - Numri i vendimeve të ardhura në IKP sipas muajve

109 vendimet e njoftuara nga KPK, gjatë vitit 2022, kanë dispozitiv:

- 50 konfirmime;
- 36 shkarkime;
- 23 të deklarojë se procesi është ndërprerë.

Të shprehura në përqindje të dhënat e dispozitivëve janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm nr. 5.


**Vendime të njoftuara sipas dispozitivit
(total 109 vendime) - viti 2022**



Grafiku nr. 5 - Vendime të njoftuara nga KPK - viti 2022, sipas dispozitivit


Në grafikun nr. 6 paraqitet, në mënyrë më të përmblodhur, dispozitivi i vendimeve të ardhura nga KPK-ja, sipas muajve, për vitin 2022.

Dispozitivi i vendimeve të njoftuara, sipas muajve - viti 2022



Grafiku nr. 6 - Dispozitivi i vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK sipas muajve, viti 2022


Dispozitivi i vendimeve të njoftuara në vite: 2018-2022



Grafiku nr. 7 - Dispozitivi i vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK sipas viteve 2018-2022


Subjektet e rivlerësimit, 109 subjekte në total, për të cilët janë njoftuar vendimet nga KPK-ja, janë të funksioneve të ndryshme. Në grafikun e mëposhtëm, tregohet numri i gjyqtarëve, i prokurorëve dhe të funksioneve të tjera si: Inspektorë, Ndihmës ligjorë dhe Këshilltarë ligjorë.

Subjekte të rivlerësuar sipas funksioneve - 2022



Grafiku nr. 8 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, viti 2022

Subjektet e rivlerësuar sipas funksioneve në vite, 2018-2022




Grafiku nr. 9 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, krahasuar në vite

Në grafikun krahasimor nr. 9 rezulton se numri i gjyqtarëve, në 5 vjet, është më i lartë se numri i prokurorëve.

- Rekomandime të ardhura nga ONM-ja

Referuar nenit 65/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit B, pika c e aneksit të Kushtetutës, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).

Rekomandime nga ONM në vite: 2018-2022




Grafiku nr. 10 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas viteve

Nga grafiku 10 vihet re se viti 2021 ka numrin më të lartë të rekomandimeve.

Në të gjitha rastet e rekomandimeve të ardhura në IKP, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka ushtruar ankim kundër vendimeve të KPK-së.

- Shqyrtimi i vendimeve nga Komisionerët Publikë


Për vendimet e njoftuara nga KPK gjatë vitit 2022, pas shqyrtimit të tyre, në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 11 vendime të KPK-së. Për 98 vendime është njoftuar mosankim.



Grafiku nr. 11 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, viti 2022

Në grafikun nr.12 pasqyrohen të dhënat mbi vendimmarrjen e Komisionerëve Publikë në shqyrtimin e vendimeve të njoftuara nga KPK-ja, në vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.


Shqyrtimi i vendimeve të KPK-së në vite, 2018-2022



Grafiku nr. 12 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, në vitet 2018-2022

Në grafikun nr.13 janë paraqitur ankimet dhe mosankimet për vitin 2022, sipas muajve të njoftimit të vendimeve në IKP.


Ankime e mosankime të vendimeve të njoftuara sipas muajve - viti 2022



Grafiku nr. 13 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas muajve

Në grafikët e mëposhtëm tregohet statusi i subjektit të rivlerësimit nën këndvështrimin e vendimmarrjes së Komisionerëve Publikë, si për vitin 2022, edhe në vitet paraardhëse: 2018, 2019, 2020 dhe 2021.


Ankime/mosankime sipas funksionit të subjekteve të rivlerësimit - viti 2022



Grafiku nr. 14 -Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit

Në krahasim me katër vitet paraardhëse, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, situata paraqitet në grafikun nr.15.


Ankimet sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, 2018-2022



Grafiku nr. 15 - Ankimet e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, në vitet 2018-2022

- Denoncimet nga publiku


Administrimi i denoncimeve nga publiku ushtrohet në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë, në faqen zyrtare të IKP-së, “Formulari i Denoncimit nga Publiku” është vendosur në një menu të veçantë, të dukshme, si dhe në tabelën e Programit të Transparencës. Formularët, të plotësuar dorazi nga vetë qytetarët dhe të dërguar në rrugë elektronike, administrohen nga Specialisti i Pritjes me popullin.



Grafiku nr. 16 - Denoncimet nga publiku, sipas muajve, viti 2022

Nëse i referohemi grafikut, numri më i lartë i denoncimeve është në muajin shkurt, 24 denoncime.


Nëse bëjmë një analizë të funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë denoncuar nga publiku, në IKP, për vitin 2022, rezulton se denoncimet janë kryesisht për gjyqtarë dhe prokurorë, sikurse pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku nr. 17- Denoncimet nga publiku, sipas subjekteve të rivlerësimit, viti 2022

Ecuria e denoncimeve nga publiku të administruara në IKP gjatë 5 viteve: 2018 - 2022, është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm nr. 18, ku rezulton se numri më i lartë i denoncimeve të administruara dhe i subjekteve të denoncuar, është në vitin 2019, me 361 të tilla, e 710 subjekteve të denoncuar. Saktësojmë faktin se 1 denoncues mund të denoncojë më shumë se 1(një) subjekt rivlerësimi.

Numri i denoncimeve nga publiku në vite: 2018 - 2022




Grafiku nr. 18 - Denoncimet nga publiku në vite, 2018 – 2019 – 2020 – 2021 – 2022

- Pjesëmarrja në seancat e gjykimit të ankimit të IKP-së në KPA

Referuar neneve 5, pika 2, 63, pika 1, 65, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e ankimit të vendimit të KPK-së, nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) e gjykon çështjen në seancë publike.

Seancat e zhvilluara në vite, ku seanca e parë daton më 16 maj 2018 dhe e fundit më 21 dhjetor 2022, janë në total **279** të tilla.

Seancat gjyqësore, 2018-2022



Grafiku nr. 19 - Numri i seancave në të cilat kanë marrë pjesë KP në vite, 2018 - 2022

II. BUXHETI DHE MENAXHIMI I FONDEVE PUBLIKE

Me ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, janë miratuar fondet buxhetore për Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Gjatë vitit 2022, zbatimi i buxhetit të institucionit është bazuar në legjislacionin në fuqi, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore rregullatore, aktet nënligjore në fushën e zbatimit të buxhetit të shtetit, si dhe drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Në zbatimin e buxhetit të vitit 2022 jemi mbështetur, gjithashtu, në parimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore. Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për këtë vit është në nivelin 99.8% ose 2% më e lartë se në vitin 2021.


Situata buxhetore për vitin 2022 paraqitet në vijim, në formë tabelore dhe grafike.

Me ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, u miratua buxheti total vjetor për Institucionin e Komisionerëve Publikë, në vlerën 75,728 lekë, i ndarë në 73,728 mijë lekë në shpenzime korente dhe 2,000 mijë lekë në shpenzime kapitale.


Gjatë vitit, ky buxhet ka pësuar ndryshime me akte normative, si dhe me rialokime brenda shpenzimeve korente, të cilat do të analizohen në vijim. Buxheti i rishikuar arriti në 76,835 mijë lekë, duke u rritur shpenzimet korente në 76,235 mijë lekë dhe pakësuar shpenzimet kapitale në 600 mijë lekë.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	73,728	76,235	76,235	100 %
Shpenzime kapitale	2,000	600	432	72%
TOTALI	75,728	76,835	76,667	99,8 %



Grafiku nr. 20 - Situata buxhetore në vitin 2022



Grafiku nr. 21 - Realizimi i buxhetit 2018-2022

Për sa i përket shpenzimeve të kryera për furnizimin materialo-teknik të stafit të institucionit, administrimin e nevojave të institucionit dhe krijimin e kushteve optimale të punës, theksojmë se ato janë kryer brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2022, në përputhje me dispozitat ligjore dhe në bazë të parimit të efektivitetit, eficiencës dhe economicitetit.

Gjatë këtij viti janë kryer disa procedura prokurimi në zbatim të dispozitave ligjore në fushën e prokurimit publik dhe në përputhje me Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit Publik, të miratuar në fillim të vitit dhe të ndryshuar sipas rastit, për shkak të ndryshimeve që ka pësuar buxheti ose me argumentimin e nevojave të reja të lindura gjatë vitit.

Janë finalizuar me sukses dhe në afatet e përcaktuara kohore procedurat e prokurimit të planifikuara për blerje mallrash dhe shërbimesh, ndër të cilat, 9 procedura prokurimi të blerjeve me vlerë të vogël mbi 100,000 lekë pa TVSH dhe 13 procedura për blerje, për mallra dhe shërbime, me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSH, me procedura të thjeshtuara, sipas përcaktimeve ligjore.

Është kryer marrja në dorëzim dhe verifikimi i të gjitha aktiveve të furnizuara nga këto procedura prokurimi, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30/2011, të ndryshuar, dhe në përputhje me gjurmët e auditit, të miratuara në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Projektbuxheti 2023-2025

Institucioni i Komisionerëve Publikë i ka paraqitur kërkesat buxhetore dhe dokumentin e Projektbuxhetit afatmesëm 2023-2025, brenda afateve ligjore, në Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ka ndjekur të gjithë hapat ligjorë për paraqitjen dhe argumentimin në kohë të kërkesave buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Kërkesat buxhetore për këtë periudhë afatmesme janë përgatitur duke respektuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin për procedurat standarde të hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Përpunimi i detajeve teknike të buxhetit është kryer brenda tavaneve përfundimtare të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 535, datë 29.7.2022, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Për Institucionin e Komisionerëve Publikë këto tavane ishin në të njëjtin nivel me kërkesat buxhetore të institucionit, duke plotësuar në këtë mënyrë të gjithë nevojat buxhetore të përgatitura nga Ekipi i Menaxhimit të Programit dhe duke respektuar rregullat dhe procedurat standarde të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Këto kërkesa përfshijnë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit, sipas strukturës organike të miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, të ndryshuar, si dhe shpenzime për mallra dhe shërbime të domosdoshme për aktivitetin e institucionit.

Nga Grupi i Menaxhimit Strategjik janë theksuar dy problematika që afektojnë Projektbuxhetin Afatmesëm 2023-2025:

- me mungesën e akteve përkatëse rregullatore, është e vështirë të parashikohet numri i stafit që do të vijojë punën për mbylljen e institucionit pas përfundimit të mandatit kushtetues, dhe kërkesat buxhetore

për vitin 2025 janë paraqitur në përputhje me tavanet përfundimtare të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

- lidhur me metodologjinë e llogaritjes së pagave për Komisionerët Publikë dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, sa i përket elementit “pagë referuese bazë”, sipas rekomandimit të KLSH-së në institucionet e drejtësisë, për mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjit nr. 96/2016, lidhur me pagën e magjistratit.

Me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i vitit 2023, shpenzimet sipas programeve dhe shpenzimet e tjera për vitet 2024-2025. Kufijtë e shpenzimeve të miratuara për Institucionin e Komisionerëve Publikë plotësojnë kërkesat e institucionit në shpenzime operative dhe kapitale, ndërsa në shpenzimet e personelit është reflektuar rritja e pagave pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 621, datë 28.9.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike’ ”.